

VENDIM
Nr.671, datë 28.9.2011

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E CILA PREKET NGA NDËRTIMI I SHKOLLËS 9-
VJEÇARE, LAKNAS, KAMËZ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i shkollës 9-vjeçare, Laknas, Kamëz.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë Kamëz.
 3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen e përgjithshme 4000 (katër mijë) m² tokë/truall, e vlerësuar me 1375 (një mijë e treqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë/m², me vlerë të përgjithshme 5 500 000 (pesë milionë e pesëqind mijë) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale të përballohen nga bashkia Kamëz.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 5 500 000 (pesë milionë e pesëqind mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës,
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit dhjetor 2011.
 7. Bashkia Kamëz të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Bashkia Kamëz, si përfituesi për të cilin kryhet procedura e shpronësimit, të kryejë regjistrimin e pasurisë së paluajtshme që shpronësohet pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë.
 9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bashkia Kamëz dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha